

VENDIM
Nr.282, datë 25.6.1992

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET DHE
TË NIVELIT TË QIRASË PËR OBJEKTE QË U JEPEN NË PËRDORIM TË TRETËVE**

Në zbatim të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prona shtetërore që privatizohet (mjetet kryesore) të vlerësohet në bazë të vleftës fillestare dhe shumës së amortizimit të regjistruar në kontabilitet, si dhe sipas vlerësimit në varësi nga gjendja fizike.

Kur objekti që privatizohet nuk ka vleftë fillestare të regjistruar në kontabilitet vlerësimi të bëhet nga komisioni i vlerësimit sipas çmimeve ose manualeve që kanë qenë në fuqi për vitet 1991-1995 ose vleftës së objekteve me natyrë të përafërt me të.

2. Komisioni i vlerësimit në ndërmarrje a institucion caktohet nga drejtuesi i tyre dhe mban përgjegjësi ligjore për saktësinë e veprimeve të kryera. Në përbërje të komisionit marrin pjesë detyrimisht edhe punonjës të seksionit të financës dhe seksioneve përkatëse në organet e pushtetit lokal.

3. Vlera e mjeteve kryesore që përcaktohet në pikën 1 të këtij vendimi dhe që privatizohen ose përfshihen si pjesë e kapitalit shqiptar në ndërmarrjet e përbashkëta me kapitalin e huaj të korrigjohet me indeks të çmimeve të konsumit në momntin e përfundimit të vlerësimit në ndërmarrjen a institucionin përkatës, në krahasim me çmimet e muajit dhjetor të vitit 1991. Ky indeks të jepet zyrtarisht nga drejtoria e statistikës një herë në muaj.

4. Kur objekti që privatizohet është pasuri e paluajtshme vleftës së përcaktuar sipas pikës 3 të këtij vendimi i bëhen edhe këto shtesa:

a) Kur ai ndodhet në periferi të qytetit ose të qendrës së banuar shtesa e vleftës të jetë 10 për qind.

b) Kur ai ndodhet ndërmejet periferisë së qytetit ose qendrës së banuar shtesa e vleftës të jetë 15 për qind.

c) Kur ai ndodhet në qendër të qytetit a qendrës së banuar shtesa e vleftës të jetë 20 për qind.

5. Në objektet që shiten ose jepen me qira, vlefta e trullit përfshihet si zë i veçantë në vlerësimin e tyre.

6. Kulturat drufrutorë, kafshët e punës e të prodhimit e të tjera të kësaj natyre vlerësohen sipas pikës 1 dhe 3 të këtij vendimi duke marrë parasysh periudhën e vegjetacionit, vleftën e prodhimit në proces dhe vleftën zooteknike, kurse për kulturat drufrutorë edhe vendndodhja e vlerësuar sipas pikës 4 të këtij vendimi.

7. Mjetet xhiruese (të prodhuara në vend ose të importuara) vlerësohen dhe u shiten personave fizikë e juridikë privatë me çmimet me pakicë të tregut të lirë. Për inventarin e imët dhe ambalazhet, vleftës fillestare i zbritet amortizimi, sipas shkallës reale të konsumit.

8. Marrëdhëniet debitoare e kreditore, shtetërore e private, nuk përfshihen në vleftën e pronës shtetërore që kalon në pronësi private. Këto të sistemohen sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë për këtë problem.

9. Të ardhurat që realizohen nga shitja e pronës shtetërore derdhen në buxhetin e shtetit.

10. Qiraja për objektet e ndryshme të ndërmarrjeve e të institucioneve shtetërore që u jepen në përdorim të tretëve, përcaktohet duke u bazuar në vlerën fillestare sipas pikës 1 të këtij vendimi, normat e amortizimit në fuqi dhe një rritje jo më pak se 50 për qind të qirasë vjetore.

11. Kur objekti merret me qira nga të huajt ose personat fizikë e juridikë vendas që bashkërpunojnë me të huajt qiraja e përcaktuar sipas pikës 10 të këtij vendimi shumëzohet me koeficientin 8 (tetë).

12. Qiraja e përcaktuar sipas këtyre kriterëve të shërbejë si bazë nisjeje për dhënien me qira të objekteve nëpërmjet ankandit.

13. Kur objekti jepet me qira për më pak se një muaj qiramarrësi paguan qiranë para se ai të marrë objektin në përdorim.

Drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve, për objektet që kanë në administrimin e tyre, kanë të drejtë t'u japin me qira objekte nëpërmjet ankandit me vlerë fillestare nën 500 mijë lekë personave juridikë e fizikë vendas e të huaj me afat deri në 5 vjet. Ankandi organizohet nga dega e agjencisë sipas udhëzimit përkatës.

14. Qiraja e arkëtuar nga qiramarrësit përfshihet në fitimin e ndërmarrjes a të institucionit me drejtim ekonomik dhe përdoret sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat në fuqi. Në institucionet buxhetore 50 për qind e këtyre të ardhurave derdhen në buxhetin e shtetit.

15. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të nxjerrin udhëzimet përkatëse Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, brenda 15 ditëve nga dalja e vendimit

16. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.362, datë 23.9.1991 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që do të privatizohet", pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.482, datë 24.12.1991, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.13, datë 10.1.1992 "Për rivlerësimin e mjeteve kryesore të ndërmarrjeve ekonomike dhe të institucioneve buxhetore që janë pronë e shtetit" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.365, datë 5.10.1991 "Për përcaktimin e nivelit të qirasë së objekteve të ndryshme të ndërmarrjeve e të institucioneve shtetërore që u jepen në përdorim të tretëve", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi